



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë , më \_\_\_/\_\_\_/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: **OB “3i-Solutions” & “SYNAPSE ATS” sh.p.k**

Adresa: **Tirane , Rruga "Stavro Vinjau", Pallati 2. H. 9, Zona Kadastrale Nr. 8160**

Adresa: **Tirane, Njesia 7, Rruga Dritan Hoxha, Pallati MC-Inerte, Kati 2.**

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-46672-12-23-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje pajisje dhe sistem operativ për modernizimin e teknologjisë Call Center (Nr. i Gjelbërt).”**

Fond limit 5.000.000(pesë milion) lekë pa tvsh,

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*):

Buletini i Njoftimeve Publike *Nr.52 date 30.10.2019*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“PC Store” sh.p.k** L01606034A

Vlera **4,660,000** (katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh .

2. **“3i-Solutions” & “SYNAPSE ATS” sh.p.k** L52305007S & L12321011H

Vlera **4,756,565** (katër milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “PC Store” sh.p.k

L01606034A

Vlera **4,660,000** (katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh .

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store”shpk me vlerë **4,660,000** (katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se oferta përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.Më datë 10.01.2020 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik “PC Store”shpk me lëndë ”Kërkesë per terheqje nga procedura” prot hyrës 640,datë 10.01.2020 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura objekt prokurimi.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “**Si rregull, në**

**procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën per tërheqje nga procedura.**” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “PC Store”shpk .

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër KVO vendos **të skualifikojë** operatorin ekonomik “PC Store”shpk.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BO: “**3i-Solutions**” & “**SYNAPSE ATS**” sh.p.k me vlerë **4,756,565** (katër milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10.01.2020**

Ankesa:**Jo**